LIGJ
Nr. 136/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995 "PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1030, DATË 23.2.1995 "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË TË PRIVATIZIMIT)" DHE TË DEKRETIT NR. 1049, DATË 27.3.1995 "PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR. 1030, DATË 23.2.1995"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Fjalia e fundit e nenit 3 të ligjit nr. 7918, datë 13.4.1995 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit)" dhe të dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995"", të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

"Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2014.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8169, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani